



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1737 / Prot. 4

Vlorë më, 29.09.2023

VENDIM
Nr. 50, datë 29.09.2023

PËR
MIRATIMIN E NJË FORMULARI VLERËSIMI TË PUNIMEVE SHKENCORE TË
BULETINIT SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja k, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismaïl Qemali", Vlorë, si dhe referuar Vendimit nr.9 të Rektoratit , prot datë 26.09.2023, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 29.09.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë një formular – vlerësimi të punimeve shkencore të Buletinit Shkencor të Universitetit "Ismaïl Qemali", Vlorë.
2. Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi materiali përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.Dr. ROLAND ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
REKTORATI

Nr. 1708 / Prot.
11

Vlorë, më 26.9.2023

VENDIM

Nr. 9, datë 20.09.2023

PËR

MIRATIMIN E NJË FORMULAR-VLERËSIMI TË PUNIMEVE SHKENCORE TË
BULETINIT SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË


Në mbështetje të neneve 93, 95 dhe 113 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në Vendimin Nr. 73, datë 10.07.2017 të Senatit Akademik, "Për miratimin e përbërjes së Bordit Editorial dhe Bordit Shkencor të Buletinit Shkencor të Universitetit "Ismaïl Qemali" Vlorë, në Strategjinë e Kërkimit Shkencor të Universitetit "Ismaïl Qemali" Vlorë si dhe të shkresës nr 1357, Prot., datë 13.07.2023 të zëvendësrektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, Rektorati, në mbledhjen e zhvilluar në datën 20.09.2023,



VENDOSI

1. Të miratojë një formular-vlerësimi të punimeve shkencore të Buletinit Shkencor të Universitetit "Ismaïl Qemali" Vlorë.
2. Bashkëlidhur shkresa nr.157 Prot, datë 13.07.2023 e zëvendësrektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional.
3. Ky vendim i përcillet për diskutim dhe miratim Senatit Akademik.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI





E. Imeraj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIM INSTITUCIONAL

Nr. 1357 Prot.

Vlorë më, 13.07.2023

Lënda: Mbi hartimin e një formulari vlerësimi të punimeve shkencore të Buletinit Shkencor të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë

PROF. DR. ROLAND ZISI
REKTORIT TË UV-SË

KËTU

Duke u mbështetur në nënenet 93, 95 dhe 113 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin Nr. 73, datë 10.07.2017 të Senatit Akademik, për miratimin e përbërjes së Bordit Editorial dhe Bordit Shkencor të Buletinit Shkencor të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë dhe në Strategjinë e Kerkimit Shkencor të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë, dhe me qëllim përmirësimin e cilësisë së punimeve shkencore të cilat publikohen tek Buletini Shkencor i Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë, bashkëngjitur, po Ju përcjell draftin e një 'Formulari të vlerësimit të punimeve shkencore' të cilat paraqiten për botim në Buletinin Shkencor, për miratim në Rektorat.


Formulari synon të jetë një mjet ndihmues në vlerësimin e punimeve shkencore për Bordin Shkencor të Buletinit, duke standartizuar rregullat e vlerësimit të punimeve. Punimet shkencore do të vlerësohen nga anëtarët e Bordit Shkencor ose nga vlersues të jashtëm (në bazë të nevojave). Secili artikull i cili dorëzohet për publikim pranë Buletinit Shkencor të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë, do të vlersohet nga të paktën një vlersues të jashtëm i cili do të përdori këtë formular. Identifikimi i autorëve tek vlersuesi si dhe emri i vlersuesit tek autorët nuk do të bëhen të njohura. Një kopje e formularit të vlerësimit do të ruhet në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

ZV. REKTORI
PROF. ASOC. ENKELEJD MËHILLI



Buletini shkencor Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë



Formulari i vlerësimit të punimit

Ky formular është krijuar për të përmbledhur vlerësimin e punimit shkencor të cilin keni marrë për të vlerësuar. Ky formular nuk do ti bëhet me dije autorit/ëve. Vlerësimi juaj duhet të jetë i qartë, objektiv dhe i paanshëm. Është e nevojshme të jepni sugjerimet/komentet tuaja për modifikimet e nevojshme ose arsyet specifike të refuzimit përpara se punimi të publikohet.

Ju lutemi, përgjigjuni brenda kohës së caktuar në mënyrë që të mund t'u japim autorëve përgjigje dhe sugjerime brenda afateve.

Kriteret e vlerësimit :

Ju lutemi jepni një vlerësim numerik në një shkallë nga një (1) deri në pesë (5). Numër më i vogël i përshtatet një vlerësimi më të ulët ndërsa numër më i madh i përshtatet një vlerësimi më të lart.

<i>Pyetje</i>	<i>Rezultati i vlerësimit</i> [Dobët] 1-5 [Shkëlqyeshëm]
1. Titulli është i qartë dhe është adekuat me përmbajtjen e artikullit. <i>(Rekomandohet një shpjegim i shkurtër)</i>	
2. Abstrakti është i strukturuar dhe paraqet qartë objektivat, metodologjinë dhe rezultatet. <i>(Rekomandohet një shpjegim)</i>	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIM INSTITUCIONAL


3. Literatura egzistuese paraqitet qartë dhe e detajuar <i>(Rekomandohet një shpjegim)</i>	
4. Metodologjia e përdorur është e duhura dhe e prezantuar qartë <i>(Rekomandohet një shpjegim)</i>	
5. Rezultatet janë prezantuar qartë dhe në mënyrë të detajuar <i>(Rekomandohet një shpjegim)</i>	
6. Konkluzionet/rekomandimet vinë si pasojë e rezultateve të gjetura <i>(Rekomandohet një shpjegim)</i>	
7. Punimi nuk ka nevojë për kontroll gramatikor dhe drejtshkrimor. <i>(Rekomandohet një shpjegim i shkurtër)</i>	
8. Referencat janë gjithëpërfshirëse dhe sipas stilit të citimit Vancouver. <i>(Të gjitha burimet në listën e referencave citohen në tekst dhe anasjelltas)</i> <i>(Rekomandohet një shpjegim i shkurtër)</i>	

Rekomandimi i përgjithshëm R (shënoni një X me rekomandimin tuaj):

Pranuar, nuk ka nevojë për rishikim	
Pranuar, nevojiten rishikime të vogla	
Kthetur për rishikim të madh dhe ridorëzim	
Refuzur	

Pikat e forta dhe të dobta të punimit:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIM INSTITUCIONAL

Komente dhe sugjerime për autorin (ët):

.....
.....
.....

Komentet dhe sugjerimet vetëm për redaktorët:

.....
.....
.....

Ju falenderojmë për kohën dhe punën tuaj!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë më, 14.07.2023

Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Prejzuar:

- > Senati
- > Rektorati
- > Këshilli Etikës
- > Rektori
 - > Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
 - > Sektori Juridik
 - > Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
 - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
 - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
 - Sektori i IT-së
 - > Bordi i Administrimit
 - > Administrator
 - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
 - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
 - Sektori i Prokurimeve
 - Sektori i Shërbimeve
 - > Njësia e Auditit të Brendshëm
 - > Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional
 - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve
 - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
 - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
 - > Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik
 - > Zv. Rektor Akademik
 - Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë
 - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
 - Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
 - > Sektori i Bibliotekes Shkencore
- > Prof. Asoc. Aurela Saliaj Dekan F.SH.
 - Kryesekretare F.SH.
- > Prof. Dr. Albert Qarri Dekan F.E
 - Kryesekretare F.E
- > Prof. As. Armela Panajoti Dekan F.SH.H.D.
 - Kryesekretare F.SH.H.D
- > Prof.As. Hajdar Klcaj Dekan F.SH.T.N.
 - Kryesekretare F.SH.T.N

REKTORI

Prof. Dr. Ardit ZISI